REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA

Nr. 1604 prot Tiranë, më 08.10.2020

Lënda: Kërkesë për ndryshimin e emrit të Administratorit

QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT
Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve,Tiranë

Bazuar në ligjin 10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" i ndryshuar si dhe në zbatim të Vendimit nr. 16, datë 01.08.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndër të tjera është vendosur sekuestrimi i pasurive të më poshtme:

1. 51% të kuotave të shoqërisë "Landon" sh.p.k, me numër NIPT K92226004H.
2. Kuotat dhe aksionet e shoqërisë "YLDON" sh.p.k, me numër NIPT K31618007S. Ndersa për sa i përket Administratorit të njësis (kantierit) do vazhdoj të qëndroj në detyrë administrator njësie (kantieri) Z Armelind Shahinas i datëlindjes 15.01.1976 me ID H60115080J.
3. Kuotat dhe aksionet e shoqërisë "Redon OIL" shpk, me numër NIPT L57716501I.
4. Kuotat dhe aksionet e shoqërisë "DON-UCD" shpk, me numër NIPT L51326022D.
5. 80% të kuotave dhe aksioneve të shoqërisë "Ecogades Landon Balcan" sh.a me numër NIPT L22006005S, me aksioner shoqërinë " London".
6. 30% të kuotave dhe aksioneve të shoqërisë "CHANNEL ONE" shpk me numër NIPT K12412002L. (Bashkëlidhur shkresa Nr.1198/3 prot., datë 05.10.2020 e Agjensisë për Administrimin e Pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara dhe Vendimi i Asamblesë datë 15.09.2020 i Shoqërise Channel One sh.p.k, ku është emëruar Administrator znj. Anxhela Babaliu).

7. 50% të kuotave dhe aksioneve të shoqërisë "P S 31"shpk me numër NIPT L42215016R.
8. 80% të kuotave dhe aksioneve të shoqërisë "INTERKINEX" shpk, me numër NIPTJ71506006T.
9. 60% të kuotave dhe asioneve të shoqërisë "ORA" sh.a. me numër NIPT K71505003O në emër të shtetasit Ylli Ndroqi dhe 40% të kuotave në emër të shtetases Mimoza Ndroqi.
10. Kuotat dhe aksionet e shoqërisë "REN-DON" shpk me numër NIPT L41622002A.
11. 50% të kuotave dhe aksioneve të shoqërisë "ALBANIA BAY MARINE" shpk me numër NIPT L61307081M me aksioner shoqërine "YLDON".

Në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" i ndryshuar, *ligjit nr. 34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara"* i ndryshuar, si dhe *vendimit nr. 16, datë 01.08.2020, të Gjykatës së Posacme të Shkallës së Parë për Korupsionin dhe Krimin e Organizuar*, ka dalë urdhri nr.1587, datë 07.10.2020 i Kryeadministratorit i cili cakton që për administrimin e pasurive të sipër cituara ngarkohen Administratoret e Agjencisë se Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskura Z. Erion Riçku dhe Z. Erald Totri.

Për sa më sipër për të bërë të mundur administrimin sa më korrekt të shoqërive të më sipërme kërkojmë zëvendësimin e emrit të administratorit të më parshëm me Administratoret Z. Erion Riçku dhe Z. Erald Totri, sipas përcaktimeve ligjore.

- Bashkangjitur do gjeni kopjen e Urdhërit të brendshëm *nr. 1587, datë 07.10.2020, të Agjencisesë të Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.*
- Bashkangjitur do gjeni kopjen e ID të Administratorëve të cituar në Urdhërit të brendshëm *nr. 1587, datë 07.10.2020, të Agjencisesë të Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.*
- Bashkangjitur do gjeni kopjen e *vendimit nr. 16, datë 01.08.2020, të Gjykatës së Posacme të Shkallës së Parë për Korupsionin dhe Krimin e Organizuar.*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYEADMINISTRATOR

Artur Kala